



GLOBAL
DOWN SYNDROME FOUNDATION®



GLOBAL DOWN SYNDROME FOUNDATION
UDHËZIME PËR KUJDESIN MJEKËSOR
për TË RRITURIT ME SINDROMËN DOWN

Versioni për familjet

Hyrje 02

1	Sjellja	12
2	Demenca	16
3	Diabeti	20
4	Sëmundja kardiovaskulare	22
5	Obeziteti	26
6	Instabiliteti atlantoaksial	28
7	Osteoporoza	30
8	Tiroidja	34
9	Sëmundja Celiake	36

Shtojcat dhe referencat 38



Një falënderim i veçantë për Down Syndrome Albania dhe Down Syndrome Kosova për mbështetjen e tyre në përkthimin në gjuhën shqipe.

AUTORËT

Peter Bulova, MD

George Capone, MD

Brian Chicoine, MD

Bryn Gelaro, MA, LSW

**Terry Odell Harville, MD, PhD,
D(ABMLI), F(ACHI)**

Barry A. Martin, MD

**Dennis E. McGuire,
PhD, LCSW**

***Kent D. McKelvey, MD**

**Moya Peterson, PhD,
APRN, FNP-BC**

Amy Tsou, MD, MSc

**Carl Tyler, MD, MSc, ABFP,
CAQ-Geriatri**

Michael David Wells, BS

Michelle Sie Whitten, MA





KOMITETI I VULLNETARËVE

Jarrett Barnhill,
MD, DFAPA, FAACAP
Donald Bodenner, MD, PhD
Paul J. Camarata, MD
Kamala Gullapalli Cotts, MD
Robert H. Eckel, MD
Anna J. Esbensen, PhD
James E. Hunt, MD
Seth M. Keller, MD
Judy Lu Kim, MD
Ira T. Lott, MD
Michael T. McDermott, MD
Joan Medlen, MEd, RD, LD
Micol Rothman, MD
Stephanie L. Santoro, MD
Mary M. Stephens, MD, MPH
Elizabeth Yeung, MD

EKSPERTË TË TJERË

Joaquín M. Espinosa, PhD
Joann Fontanarosa, PhD
Gina Giradi, MS
Allison Gross, MLS
Janice Kaczmarek, MS
Lina Patel, PsyD
Michael S. Rafi, MD, PhD
Karen Schoelles, MD, SM, FACP

BASHKËPUNËTORËT KYÇË

Ritter Family

KONTRIBUUES

Burg Family Foundation

Down Syndrome Association
of Greater Richmond

Down Syndrome Guild of
Dallas

National Down Syndrome

Society

Rocky Mountain

Down Syndrome Association

MBËSHTETËSIT SHUMËVJEÇARË

arc Thrift Store

Down Syndrome Alliance
of the Midlands

Down Syndrome Association
of Atlanta

Down Syndrome Association
of Greater St. Louis

Down Syndrome Association
of Middle Tennessee

Down Syndrome Association
of Minnesota

Down Syndrome Association of
Northeast Ohio

Down Syndrome Connection of
the Bay Area

Dra. Macarena Lizama & Centro UC
Síndrome de Down

Japan Down Syndrome Association

North Carolina Down Syndrome
Alliance

MBËSHTETËSIT KYÇË

Anna & John J. Sie Center

for Down Syndrome

Charles Monfort

Down Syndrome Association
of Central Ohio

Down Syndrome Association
of Jacksonville

Down Syndrome Association
of Orange County

Down Syndrome of Louisville, Inc

Linda Crnic Institute for

Down Syndrome

National Down Syndrome Congress

Napoleone Family

MBËSHTETËS

Broward Gold Coast
Down Syndrome Organization

ChapTer 21

Designer Genes of North Dakota

Down Syndrome Affiliates in Action

Down Syndrome Alabama

Down Syndrome Association for
Families of Nebraska

Down Syndrome Association of
Acadiana

Down Syndrome Association of
Central Florida

Down Syndrome Association of
Connecticut

Down Syndrome Association of
Greater Cincinnati

Down Syndrome Association of
Northern Virginia

Fun Coast Down Syndrome
Association

The Family of Rya Gracy Pierce

MIQ

Alan P. & Veronica C. Neuman
Family Charitable Fund

Alaska Down Syndrome Network

Chattanooga Down Syndrome
Society

Club 21 Learning and Resource
Center

David Egan and Family

Down Syndrome Association
of Central California

Down Syndrome Association
of Central Kentucky

Down Syndrome Association
of Central Oklahoma

Down Syndrome Association
of Central Texas

Down Syndrome Association
of Delaware

Down Syndrome Association
of the Brazos Valley

Down Syndrome Association of
Wisconsin, Inc.

Down Syndrome Family
Connection

Down Syndrome Foundation
of Southeastern New Mexico

Eastern Idaho Down Syndrome

Family Connect East Texas Down
Syndrome Group

Families Exploring
Down Syndrome of Brevard

International Mosaic
Down Syndrome Association

Kern Down Syndrome Network

Red River Valley
Down Syndrome Society

Rio Grande Valley
Down Syndrome Association

Sampson Collaborative Law

S.M.I.L.E. on Down Syndrome

Southern Arizona Network
for Down Syndrome

Wisconsin Upside Down



HYRJE


Individët me sindromën Down kanë nevoja të ndryshme mjekësore në krahasim me individët pa sindromën Down.

Për shembull, ata janë më të rrezikuar nga disa gjendje mjekësore të caktuara dhe më pak të rrezikuar nga disa të tjera në krahasim me individët pa sindromën Down. Prandaj, kontrollet e tyre vjetore dhe ndonjëherë rruga e trajtimit mund të jenë të ndryshme.

Ekzistojnë udhëzime të kujdesit shëndetësor për fëmijët me sindromën Down të moshave 0-21 vjeç, të cilat përditësohen herë pas here^{1,2} dhe janë shumë të ndryshme nga udhëzimet shëndetësore për fëmijët pa sindromën Down. Megjithatë udhëzimet shëndetësore për të rriturit me sindromën Down janë përpiluar në vitet 1999³ dhe 2001,⁴ ato janë bazuar vetëm në përvojën klinike dhe nuk janë përditësuar, edhe pse që prej asaj kohe standardet e kujdesit standardet e kujdesit.

Në vitin 2014, "Global Down Syndrome Foundation" (GLOBAL) organizoi një grup pune që përbëhej nga të rritur me sindromën Down, familjet e tyre/ofruesit e përkujdesjes dhe nga ekspertë të sindromës Down, me qëllim ngritjen e një qendre të kujdesit mjekësor për të rriturit me sindromën Down. Në bazë të përshtypjeve të marra nga ky grup pune, udhëzimet mjekësore për të rriturit me sindromën Down u identifikuan si një mjet i rëndësishëm për klinikat mjekësore dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor me qëllim mbështetjen e tyre në ofrimin e një vlerësimi dhe kujdesi më të saktë.

Si rezultat, u ngrit grupi i punës i "Global Down Syndrome Foundation" për udhërrëfyesin shëndetësor për të rriturit me sindromën Down (Grupi i punës i GLOBAL) në vitin 2016, për të përpiluar udhëzimet e para të bazuara në prova për të rriturit me sindromën Down, me qëllim përmirësimin e shëndetit të tyre. Udhërrëfyshi shëndetësor i GLOBAL për të rriturit me sindromën Down (Udhërrëfyshi i GLOBAL për të rriturit) u publikua në JAMA (Gazeta e "American Medical Association") në tetor 2020.⁵ Kjo ishte një arritje tepër e rëndësishme duke qenë se gazeta të besueshme si JAMA janë burim reference për profesionistët mjekësorë të cilët mund të gjejnë lehtësisht dhe të zbatojnë udhëzimet për pacientët e tyre të rritur me sindromën Down. Udhërrëfyshi i GLOBAL për të rriturit i publikuar në JAMA (2020) mund të gjendet online këtu: <https://bit.ly/GLOBAL-Adult-Guideline-JAMA>



Ky është versioni për familjet i Udhërrëfyesit të GLOBAL për të rriturit. Udhërrëfyshi fillestar, i plotë i GLOBAL për të rriturit u hartua për një audiencë të një niveli të lartë teknik mjekësh. Një projekt i ardhshëm është përgatitja e një versioni specifik për vetadvoim. Rekomandimet në versionin për familjet janë të njëjtat, por përbajtja është modifikuar duke shkurtuar ndjeshëm komponentët e studimeve dhe duke hequr pjesën më të madhe të metodologjisë teknike. Udhërrëfyshi fillestar i GLOBAL për të rriturit mund të gjendet online këtu:

<https://www.globaldownsyndrome.org/medical-care-guidelines-for-adults/>.

Të gjitha imazhet janë modele të miratuara nga GLOBAL.



ÇFARË ËSHTË SINDROMA DOWN?

Ka tri lloje të sindromës Down:

TRIZOMIA 21 Rreth 95% e individëve me sindromën Down kanë Trizominë 21⁶ – një gjendje mjekësore ku një individ lind me tri kopje të kromozomit 21 në çdo qelizë, dhe jo me dy kopje siç ndodh zakonisht.

TIPI TRANSLOKATIV I SINDROMËS DOWN Rreth 3% e individëve me sindromën Down kanë tipin translokativ të sindromës Down. Kjo ndodh kur një pjesë apo i gjithë kromozomi 21 bashkëngjitet (translokohet) te një kromozom tjetër.

TIPI MOZAIK I SINDROMËS DOWN Rreth 2% e individëve me sindromën Down kanë tipin mozaik të sindromës Down.⁶ Kjo ndodh kur vetëm disa qeliza të një individi (jo të gjitha) kanë një kopje shtesë të kromozomit 21.

Sindroma Down është gjendja kromozomike⁷ dhe shkaktoni i vonësës zhvillimore më i përhapur në Shtetet e Bashkuara. Sindroma Down nuk është sëmundje, por një gjendje gjenetike. Pothuajse 1 në çdo 691 foshnja lindin me këtë sindromë.⁸ Në më të shumtën e rasteve, sindroma Down është rastësore dhe jo e trashëguar.⁹ Shkaku i sindromës Down nuk dihet ende.

DUKE QENË SE AJO NDIKON NË TË GJITHA SISTEMET TRUPORE, INDIVIDËT ME SINDROMËN DOWN JANË MË TË RREZIKUAR NGA DISA SËMUNDJE TË CAKTUARA DHE MË PAK TË RREZIKUAR NGA DISA TË TJERA NË KRAHASIM ME INDIVIDËT PA SINDROMËN DOWN, PRANDAJ ATA KANË NEVOJË PËR KUJDES TË VEÇANTË MJEKËSOR.

Individët me sindromën Down janë më pak të rrezikuar nga masat malinje solide (tumoret kanceroze) apo nga sëmundjet kardiovaskulare aterosklerotike (bllokimi i arterieve), në krahasim me individët pa sindromën Down.¹⁰ ¹¹ Problemet mjekësore nga të cilat janë më të rrezikuar individët me sindromën Down përfshijnë sëmundjet autoimmune, leuceminë, infeksionet e traktit respirator, apnenë e gjumit, humbjen e dëgjimit dhe shikimit, si dhe demencën. Kjo nuk do të thotë se çdo individ me sindromën Down vuan nga të gjitha këto probleme apo ndonjë prej tyre. Gjithashtu, pjesa më e madhe e këtyre problemeve mund të diagnostikohen dhe të trajtohen që në fazë të hershme, çka do të thotë se individët me sindromën Down që vuajnë nga këto probleme mundet ende të gëzojnë një cilësi të mirë jete.¹²

Pjesa më e madhe e individëve me sindromën Down kanë aftësi të kufizuara intelektuale.² Sindroma Down shfaqet në mënyra të ndryshme te çdo individ me këtë sindromë, por disa nga karakteristikat e përbashkëta përfshijnë aftësitë e kufizuara gjuhësore, koordinimin e vonuar të muskujve dhe kapacitetin e reduktuar të funksioneve ekzekutive. Disa vështirësi të tjera sociale dhe mjedisore, si gjetja e shërbimeve të kualifikuara të kujdesit shëndetësor apo mungesa e aksesit, mund ta komplikojnë edhe më tej situatën dhe duhet të merren gjithashtu parasysh si pjesë e kujdesit për të rriturit me sindromën Down.

RRETH KËTIJ UDHËRRËFYTESI

Udhërrëfyti i GLOBAL për të rriturit përqendrohet tek të rriturit mbi 21 vjeç me tipin e sindromës Down të njohur si Trizomia 21. Duke qenë se sindroma Down ndikon në çdo pjesë të trupit,¹⁷ ishte e pamundur të mbulohej çdo fushë mjekësore në këtë botim të parë të udhëzimeve. Grupi i punës i GLOBAL vendosi të përqendrohej te nëntë prej problemeve më të zakonshme dhe më shqetësuese, të cilat janë:

- | | | |
|------------|--------------------------------|---------------------|
| 1. Sjellja | 4. Sëmundja kardiovaskulare | 7. Osteoporoza |
| 2. Demenca | 5. Obeziteti | 8. Tiroidja |
| 3. Diabeti | 6. Instabiliteti atlantoaksial | 9. Sëmundja celiake |

Duke qenë se ka ende shumë fusha të tjera mjekësore që mendojmë se janë të rëndësishme dhe unike për individët me sindromën Down, GLOBAL është angazhuar të investojë kohë, energji dhe fonde për të përditësuar udhërrëfytesin e GLOBAL për të rriturit çdo 5-6 vite me përditësime dhe fusha mjekësore të reja krahas atyre nëntë fillestareve. Aktualisht, grupi i punës i GLOBAL po zhvillon kërkime edhe mbi apnenë e gjumit, tumoret solide, leuceminë, çrregullime të tjera autoimmune, problemet me sytë dhe shikimin si dhe fizioterapinë dhe fitnesin .

Si rezultat i drejtpërdrejtë i advokimit të GLOBAL në Uashington DC, vlera e financimit për kërkimet për sindromën Down u rrit nga 27 milionë \$ në vitin 2016 në 115 milionë \$ në vitin 2022. GLOBAL pret që rritja e financimit të vazhdojë dhe do të kërkojë përsëri mbështetje me qëllim rritjen e jetëgjatësisë dhe përmirësimin e rezultateve shëndetësore, me fokus shtesë tek të rriturit me sindromën Down. Në të ardhmen, ne dëshirojmë gjithashtu të studiojmë diagnozën e dyfishtë të autizmit dhe sindromës Down, tipin mozaik të sindromës Down dhe pabarazitë në shëndet në gjini dhe raca të ndryshme tek të rriturit me sindromën Down.

PREVALENCA DHE CIKLI I JETËS

Në SHBA, individët me sindromën Down tashmë jetojnë më gjatë se kurrë më parë. Nga vitet 1980¹³ deri në kohët e sotme¹⁴ jetëgjatësia e individëve me sindromën Down është rritur nga 25 vite në 60 vite.

Jetëgjatësia e individëve me sindromën Down është rritur sepse i është dhënë fund praktikës së institucionalizimit të tyre dhe sepse ka pasur përmirësime të ndjeshme në trajtimin e problemeve kardilogjike pediatrike, hipotiroidizmit dhe sëmundjes së mushkërive, si dhe përmirësim në aksesin në kujdesin mjekësor, arsimim, mbështetjen komunitare dhe mundësi të tjera. Gjithashtu, ka pasur rritje të numrit të foshnjave të lindura me sindromën Down.^{8,15}

Qeveria nuk e mban nën kontroll numrin e individëve me sindromën Down, kështu që askush nuk e di me siguri shifrën totale të popullatës me këtë sindromë. Sipas një vlerësimi të vitit 2010, në SHBA ka 206 000 individë me sindromën Down, 125 000 prej të cilëve janë të rritur.¹⁶ Nëse këto shifra i përditësojmë sipas aktualitetit, mund të ketë mbi 400 000 individë me sindromën Down.

Edhe pse ka më shumë individë me sindromën Down, por me një jetëgjatësi më të madhe, ne duhet të punojmë më shumë në fushat kërkimore dhe të kujdesit mjekësor me qëllim që të ndihmojmë individët me sindromën Down që të jenë të shëndetshëm gjatë gjithë viteve të moshës madhore.

SFIDAT E UDHËRRËFYESIT TË GLOBAL PËR TË RRRITURIT


Sfida më e madhe gjatë përpilimit të udhërrëfyesit të GLOBAL për të rriturit ishte padisponueshmëria e kërkimeve të mjaftueshme e cilësore për sindromën Down ose kërkimeve që përfshijnë individët me sindromën Down. Nevojiten më shumë kërkime për të mbështetur mënyrën e ofrimit të kujdesit mjekësor dhe për të përfshirë në udhërrëfyes rekomandime më të mira. Këto kërkime duhet të financohen nga "National Institutes of Health" (NIH) së bashku me universitetet, spitalet dhe çdo organizatë tjetër advokuese dhe mjekësore në komunitetin e sindromës Down. Edhe në mungesë të këtyre kërkimeve, grupi i punës i GLOBAL arriti të ofronte rekomandime të sakta bazuar në përvojën klinike prej disa dekadash dhe kërkimet e kufizuara në dispozicion. Në kushtet e padisponueshmërisë së kërkimeve për të rriturit me sindromën Down, ne konsultuam kërkimet për grupe të tjera, si p.sh. për fëmijët me sindromën Down apo për të rriturit me aftësi të tjera të kufizuara për të vendosur nëse ato udhëzime mund të ishin të vlefshme.¹⁸

METODAT

Ajo çfarë e bën Udhërrëfyesin e GLOBAL për të rriturit të parin e llojit të vet është fakti se bazohet në prova, që do të thotë se autorët kanë shqyrtuar artikujt kërkimorë, kanë identifikuar artikujt që kanë vlerësuar si më cilësorë dhe, më pas, i kanë bazuar rekomandimet e tyre në konstatimet nga këto kërkime. Në mënyrë që të mbështetet në prova, grupi i punës i GLOBAL ka rekrutuar ekspertë për udhëzimet nga ECRI dhe ka ndjekur një praktikë të mirë tepër specifike të quajtur "Kudri GRADE 'Nga provat në vendimarrje'".

Pas hartimit të udhërrëfyesit, ne u kërkua të rriturve me sindromën Down dhe familjarëve të tyre të jepnin përshtypjet lidhur me të nëpërmjet një ankete online. GLOBAL u ka kërkuar gjithashtu profesionistëve mjekësorë të "American Academy of Developmental Medicine and Dentistry" që të shqyrtojnë draftin e udhërrëfyesit dhe të japin përshtypjet e tyre. Bazuar tek anketa dhe përshtypjet, grupi i punës i GLOBAL bëri disa ndryshime të rëndësishme në Udhërrëfyesin e GLOBAL për të rriturit para se ta publikonte atë.

Për të shqyrtuar metodologjinë e përfunduar, vizitoni versionin e plotë të Udhërrëfyesit të GLOBAL për të rriturit këtu: <https://www.globaldownsyndrome.org/medical-care-guidelines-for-adults/>



1

SJELLJA



★ Deklarata e praktikës së mirë 1 Nevojitet kryerja e një shqyrtimi të faktorëve të sjelljes dhe atyre funksionalë, përshtatës dhe psikosocialë si pjesë e një historie vjetore që klinikistët marrin nga të gjithë të rriturit me sindromën Down, familjet e tyre dhe ofruesit e tyre të përkujdesjes.

Të rriturit me sindromën Down duhet të përfitojnë të njëjtin nivel kujdesi mjekësor si të rriturit pa sindromën Down. Këtu duhet të përfshihet një shqyrtim vjetor i të gjithë faktorëve përkatës të sjelljes (gjendja emocionale, vëmendja dhe niveli i aktivitetit), atyre funksionalë-përshtatës (aftësitë sociale, komunikuese dhe të jetës së përditshme) dhe psikosocialë (ngjarjet e rëndësishme jetësore, humbjet/hidhërimi dhe traumat) që mund të ndikojnë në mirëqenien fizike dhe mendore. Duke qenë se të rriturit me sindromën Down mund të mos jenë në gjendje të shpjegohen saktë, familja, ofruesit e përkujdesjes dhe partnerët e tyre duhet të informojnë profesionistët mjekësorë rreth çdo ndryshimi që kanë vënë re në gjendjen emocionale apo sjelljen e të rriturit me sindromën Down. Në rast se nuk ka ndryshime të mëdha, ky informacion mund të përdoret për të përcaktuar një nivel referencë.

★ Deklarata e praktikës së mirë 2 Kur ka dyshime për çrregullime të shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down, profesionistët mjekësorë duhet të vlerësojnë gjendjet mjekësore që mund të shfaqen me simptoma psikiatrike dhe të sjelljes.

Gjendjet e shëndetit mendor dhe të sjelljes janë të zakonshme tek të rriturit me sindromën Down¹⁹ dhe përbëjnë arsye për shqetësim te familjet dhe ofruesit e tyre të përkujdesjes.

NË RAST TË NDRYSHIMEVE NË SJELLJEN APO FUNKSIONIN E NJË TË RITURI ME SINDROMËN DOWN, REKOMANDOHET TË BËHET NJË VLERËSIM MJEKËSOR DHE I SHËNDETIT MENDOR QË SHEH PËR PROBLEME TË TJERA MJEKËSORE QË MUND TË JENË SHKAKTARE TË KËTYRE SIMPTOMAVE, DUKE QENË SE NDOJËHERË GJENDJET MJEKËSORE NË DUKJE MUND TË NGATËRROHEN ME PROBLEME TË SJELLJES.²⁰⁻²³


Për shembull, shkundja e kokës kur dikush vuan nga migrena apo mospërfshirja në aktivitete për shkak të trazimit të stomakut.

REKOMANDIMI 1

Kur ka dyshime për çrregullime të shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down, profesionistët mjekësorë duhet të konsultohen me një klinikist që ka njohuri mbi çrregullimet mjekësore dhe të shëndetit mendor, si dhe mbi karakteristikat e përbashkëta të sjelljes tek të rriturit me sindromën Down.

Gjendjet e shëndetit mendor dhe të sjelljes janë të zakonshme tek të rriturit me sindromën Down¹⁹ dhe përbëjnë arsye për shqetësim te familjet dhe ofruesit e tyre të përkujdesjes. Është e rëndësishme të përcaktohet një diagnozë e saktë e çrregullimit të shëndetit mendor në mënyrë që të sigurohet trajtim i shpejtë dhe efektiv. Është gjithashtu e rëndësishme që të shmangët diagnoza e gabuar e sjelljes përshtatëse si çrregullim dhe ofrimi i një trajtimi të pasaktë. Vlerësimi për patologji të bazë përmirëson ndjeshëm kuptimin e shkaqeve që kontribuojnë në ndryshimet në sjellje apo të shëndetit mendor dhe përmirëson trajtimin.

Nuk arritëm të gjenim ndonjë studim të përshtatshëm të bazuar në prova që të krahasojë simptomat e gjendjeve të shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down me ato tek të rriturit pa sindromën Down. Megjithatë, profesionistët mjekësorë pa shumë përvojë në kujdesin për të rriturit me sindromën Down mund ta kenë të vështirë t'u ofrojnë atyre trajtimin e duhur. Për shembull, të rriturit me sindromën Down janë shumë të ndjeshëm ndaj barnave të caktuara. Trajtimi përmirësohet nëse profesionistët mjekësorë kanë njohuri rreth tolerancave dhe intolerancave ndaj barnave tek individët me sindromën Down dhe rreth mënyrave të balancimit të këtyre diferencave. Gjetja e një profesioni mjekësor që ka njohuri rreth këtyre diferencave mund të jetë e vështirë, por mund të gjeni klinikën më të afërt për sindromën Down këtu: <https://www.globaldownsyndrome.org/research-medical-care/medical-care-providers/>




REKOMANDIMI 2

Nëse ka dyshime për çrregullime të shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down, profesionistët mjekësorë duhet të ndjekin udhëzimet për diagnozën të përcaktuara në "Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders" (versioni i 5-të; DSM-5).²⁴ Gjithashtu mund të përdoret "Diagnostic Manual-Intellectual Disability 2" (DM-ID-2)²⁵ për të përshtatur kriteret diagnostike nga DSM-5.

Diagnostikimi i gjendjeve të shëndetit mendor mund të jetë i vështirë tek të rriturit me sindromën Down për shkak se sjellja e tyre mund të shfaqet ndryshe në krahasim me të rriturit pa sindromën Down. Këto diferenca mund të përfshijnë aftësitë e kufizuara në të folur, vështirësitë në përshtatjen me ndryshimet, preken nga disa probleme mjekësore në të njëjtën kohë dhe pamundësinë për të gjetur një profesionist mjekësor që ka njohuri rreth shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down. Në përvojën tonë, të rriturit me sindromën Down flasin shpesh me vete, kanë botë imagjinare/fantazi të zhvilluar dhe ndjekin disa rutina të caktuara. Disa lloje sjelljesh mund të jenë të zakonshme tek të rriturit me sindromën Down (p.sh. të folurit me vete), ndërsa disa të tjera mund të jenë shenjë e një gjendjeje të trajtueshme të shëndetit mendor (p.sh. nervozizëm, irritueshmëri). Profesionistët mjekësorë duhet të tregojnë kujdes kur supozojnë se këto sjellje janë pjesë e një çrregullimi të shëndetit mendor tek të rriturit me sindromën Down. Në vend që të pritët që të rriturit me sindromën Down të vetëraportojnë problemet e tyre emocionale, është e rëndësishme që profesionistët mjekësorë të dinë se sjelljet e keqpërshtatjes mund të shërbejnë si një tregues.

Duhet të tregohet kujdes në rast të reduktimit të aftësive tek të rriturit me sindromën Down. Humbja e funksionit mund të jetë shenjë e një çrregullimi mjekësor ose çrregullimi të shëndetit mendor. Diagnoza duhet të marrë në konsideratë sjelljet e përbashkëta dhe të bazohet te sjellja e konstatuar përveçse te vetëraportimi.²⁶⁻³⁰



2

DEMENCA





REKOMANDIMI 3

Nevojitet kujdes gjatë diagnostikimit të demencës senile të llojit Alzheimer tek të rriturit me sindromën Down nën 40 vjeç, për shkak të prevalencës së ulët të sëmundjes përpara kësaj moshe.

Dementia karakterizohet nga simptoma të humbjes së kujtesës dhe të ndryshimeve në aftësitë e të shprehurit, të menduarit dhe/ose ato funksionale. Sëmundja e Alzheimerit është një lloj demence. Ky rekomandim synon të reduktojë rastet e diagnozave të gabuara të demencës senile të llojit Alzheimer tek të rriturit me sindromën Down. Diagnoza e gabuar e demencës senile tek të rriturit me sindromën Down mund të ndodhë nëse profesionistët mjekësorë nuk bëjnë një vlerësim të kujdesshëm për gjendje të tjera mjekësore që mund të shkaktojnë gjithashtu rënie funksionale. Të rriturit me sindromën Down ka më shumë të ngjarë të preken nga dementia, por shfaqja e shenjave para moshës 40-vjeçare është e pazakontë. Është e rëndësishme që profesionistët mjekësorë që punojnë me pacientë të të gjitha moshave të marrin në konsideratë edhe shkaqet e tjera, me qëllim shmangien e diagnozës së gabuar të demencës së llojit Alzheimer. Diagnoza e gabuar pengon marrjen e trajtimit të duhur. Në mbështetje vlerësimin e kujdesshëm dhe të plotë mjekësor për të shqyrtuar nëse ka shkaqe të tjera për simptomat e llojit të demencës tek të rriturit me sindromën Down nën 40 vjeç. Edhe pse për demencën nuk ka trajtime mjekësore, ka shumë udhëzime apo trajtime që mund të vijnë në ndihmë lidhur me sjelljen, cilësinë e jetës dhe depresionin, të cilat janë të gjitha të mundshme.



REKOMANDIMI 4

Profesionistët mjekësorë duhet të kryejnë vlerësime vjetore të të rriturve me sindromën Down që nga moshë 40-vjeçare dhe të marrin informacion nga ofruesit e tyre të kujdesit parësor për çdo ndryshim nga gjendja funksionale bazë. Sipas dokumentit "National Task Group – Early Detection Screen for Dementia" (NTG-EDSD),³¹ për të identifikuar demencën senile të llojit Alzheimer në fazë të hershme dhe/ose një gjendje mjekësore potencialisht të kthyeshme, duhet të merret në konsideratë niveli i përkeqësimit në gjashtë fushat e mëposhtme:

- Funksioni konjitiv, ekzekutiv dhe kujtesa
- Sjellja dhe personaliteti
- Komunikimi
- Funksionimi përshtatës
- Aftësitë motorike dhe të deambulimit
- Përkeqësim i përgjithshëm në aftësitë e konsoliduara

Demencia senile përbën një shqetësim të zakonshëm për pjesën më të madhe të familjeve dhe ofruesve të përkujdesjes për të rriturit me sindromën Down për shkak të ndikimit që ajo ka në cilësinë e jetës. Demencia shfaqet përgjithësisht pas moshës 40-vjeçare tek individët me sindromën Down.^{32,33} Megjithatë, jo çdokush mund të preket nga demencia me kalimin e moshës. Nuk ka asnjë mënyrë për diagnostikimin e sigurt të demencës. Disa gjendje dhe simptoma që ngatërrohen shpesh me demencën përfshijnë sëmundjet cerebrovaskulare (për shembull: insulti cerebral, aneurizmat, ngushtimi i enëve të gjakut dhe sëmundja "moyamoya"), apnenë e avancuar të gjumit, problemet e metabolizmit apo efektet anësore të mjekimeve.^{31,34}

DEMENCA ËSHTË TEPËR E RRALLË PËRPARA MOSHËS 40-VJEÇARE TEK INDIVIDËT ME SINDROMËN DOWN DHE NDRYSHIMET PËRPARA KËSAJ MOSHE KANË MË SHUMË TË NGJARË TË VIJNË PËR SHKAK TË NJË PROBLEMI TJETËR SHËNDETËSOR.

Ne mendojmë se një diagnozë e saktë e demencës bazohet më shumë sesa vetëm te ndryshimet në sjellje apo personalitet. Zakonisht shfaqen ndryshime në më shumë se një aspekt, duke përfshirë kujtesën, vetëkontrollin, sjelljen, personalitetin, gjuhën, komunikimin, veprimtarinë e përditshme, kontinencën (kontrolli i fshikëzës) dhe rregullsinë e gjumit. Shenja të tjera të demencës tek të rriturit me sindromën Down përfshijnë konvulsionet, spazmat, lëvizjet e pakontrolluara të muskujve apo humbjen e aftësisë së të ecurit.

3

DIABETI



REKOMANDIMI 5

Në rastin e të rriturve asimptomatikë me sindromën Down, depistimi i diabetit melit të tipit 2 (T2DM) përmes testit të hemoglobinës A1c (HbA1c) ose matjes së glicemisë esëll duhet të kryhet çdo 3 vjet duke nisur nga mosha 30-vjeçare.

REKOMANDIMI 6

Në rastin e të rriturve me sindromën Down dhe me obezitet komorbid, depistimi për T2DM përmes HbA1c ose matjes së glicemisë esëll duhet të kryhet çdo 2-3 vjet duke nisur nga mosha 21-vjeçare.

Diabeti i llojit 2 shfaqet tek individët organizmi i të cilëve ka vështirësi në përpunimin e sheqerit (glukozës). Për të rregulluar nivelet e sheqerit, atyre u duhet të marrin mjekime dhe të jenë tepër të kujdesshëm me dietën që konsumojnë. Diabeti përbën një shqetësim të zakonshëm për të rriturit me sindromën Down, familjet e tyre dhe ofruesit e përkujdesjes, duke qenë se shumë nga individët me sindromën Down vuajnë nga obeziteti, çka mund të shkaktojë diabet. Sipas një studimi, të rriturit me sindromën Down kanë më shumë të ngjarë të vuajnë nga diabeti në krahasim me të rriturit pa sindromën Down.³⁵ Ne mendojmë se përfitimet nga depistimi për diabet i të rriturve me sindromën Down me qëllim shmangien e komplikacioneve të tjera, të tilla si problemet me trurin, sytë apo veshkat, janë më të mëdha sesa dëmet e mundshme nga trajtimi i diabetit (si efektet anësore të mjekimeve).

"American Diabetes Association" (ADA) rekomandon depistimin për diabet të të gjithë të rriturve duke nisur nga mosha 45-vjeçare.³⁶ Megjithatë, duke qenë se të rriturit me sindromën Down kanë tendencën të plaken më shpejt dhe të preken më herët nga probleme të caktuara (p.sh. perde në sy), ne rekomandojmë që të gjithë të rriturit me sindromën Down të depistohen për diabet çdo 3 vite duke nisur që nga mosha 30-vjeçare.³⁷⁻³⁹

Gjithashtu, të rriturit me sindromën Down që vuajnë nga obeziteti duhet të depistohen edhe më herët, madje dhe më shpesh – çdo 2-3 vjet, duke nisur në moshën 21-vjeçare. Depistimi i hershëm mund të rezultojë në më shumë marrje gjaku dhe mbitrajtim të diabetit pas diagnozës. Megjithatë, ne mendojmë se përfitimet janë më të mëdha sesa efektet kur bëhet fjalë për diabetin e padiagnostikuar.

4

SËMUNDJA KARDIOVASKULARE





REKOMANDIMI 7

Në rastin e të rriturve me sindromën Down, të cilët nuk kanë histori të sëmundjes kardiovaskulare aterosklerotike (ASCVD), përshtatshmëria e terapisë me statina duhet të vlerësohet çdo 5 vite, duke filluar nga moshë 40-vjeçare dhe duke përdorur një llogaritës risku në një hark kohor prej 10 vitesh, siç rekomandohet për të rriturit pa sindromën Down nga Task-Forca e Shërbimeve Parandaluese e SHBA-së (USPSTF).⁴⁰

Sëmundjet e zemrës janë shkaktari kryesor i vdekjeve në Shtetet e Bashkuara dhe sëmundja kardiovaskulare aterosklerotike (ASCVD) është shkaktari numër një i sëmundjeve të zemrës.⁴¹ ASCVD konsiston në një akumulim kolesteroli ose yndyre në arterie, çka vështirëson qarkullimin e gjakut. Nuk ka shumë të dhëna lidhur me ASCVD tek individët me sindromën Down. Megjithatë, të dhënat në dispozicion tregojnë se të rriturit me sindromën Down janë më pak të rrezikuar për t'u prekur nga sëmundjet e zemrës, çka në bazë të përvojës tonë rezultojnë të jetë konsistente.^{35, 42} USPSTF rekomandon depistimin për hiperlipidemi (yndyra në gjak, duke përfshirë kolesterolin) të të gjithë të rriturve të moshave 40-75 vjeç, për të vlerësuar riskun e sëmundjeve të zemrës.⁴⁰ Edhe pse të rriturit me sindromën Down janë më pak të rrezikuar për t'u prekur nga sëmundjet e zemrës, nuk ka mjaftueshëm kërkime që të mbështesin se trajtimi i të rriturve me sindromën Down në këtë drejtim duhet të jetë ndryshe nga ai i të rriturve pa sindromën Down. Ofruesi i kujdesit mund të llogarisë riskun së bashku me pacientin duke përdorur një llogaritës të riskut kardial bazuar në një hark kohor prej 10 vitesh. Gjithashtu, pacientët mund ta llogarisin riskun edhe vetë duke qenë se këta llogaritës janë të disponueshëm në internet dhe në formë aplikacionesh. Llogaritja e riskut mund të vijë në ndihmë në orientimin e vendimeve, p.sh. nëse duhet të merren ose jo mjekime për uljen e nivelit të kolesterolit. USPSTF rekomandon që matja e kolesterolit dhe përcaktimi i riskut të bëhen deri në moshën 75-vjeçare, pasi nuk jemi të sigurt për efikasitetin e trajtimit tek individët përtej kësaj moshe ose tek ata me jetëgjatësi të parashikuar të ulët.⁴³ Duke qenë se të rriturit me sindromën Down kanë një jetëgjatësi të parashikuar më të shkurtër (60 vite) në krahasim me të rriturit pa sindromën Down, duhet të merret në konsideratë ndërprerja e depistimit në një moshë më të re sesa të rriturit pa sindromën Down. Faktorët e tjerë të riskut për ASCVD tek individët me sindromën Down janë ende të paqartë. Ndryshe nga të rriturit pa sindromën Down, nuk ka prova që historia familjare për ASCVD të përbëjë faktor risku për të rriturit me sindromën Down. Gjithashtu, ASCVD, ndryshe nga obeziteti, është më pak i përhapur tek individët me sindromën Down, çka sugjeron se mund të ketë faktorë të tjerë më të rëndësishëm për ASCVD-në tek individët me sindromën Down.



REKOMANDIMI 8

Në rastin e të rriturve me sindromën Down, faktorët e riskut për insultin cerebral duhet të menaxhohen sipas specifikimeve në "Guidelines for the Primary Prevention of Stroke" të "American Heart Association"/"American Stroke Association".⁴⁴

REKOMANDIMI 9

Për shkak të riskut të lartë të insultit cerebral kardioembolik tek të rriturit me sindromën Down të cilët kanë histori të sëmundjeve të lindura të zemrës, duhet të kryhet vlerësim kardiak periodik dhe të shqyrtohet plani përkatës i monitorimit nga kardiologu.

Sëmundjet e lindura të zemrës janë më të zakonshme tek individët me sindromën Down. Rreth 50% e fëmijëve me sindromën Down lindin me sëmundje të lindura të zemrës.^{45,46} Këtu mund të përfshihen "vrimat në zemër" ose anomali të valvulave të zemrës. Të rriturit me sindromën Down të cilët kanë vuajtur nga një sëmundje e lindur e zemrës (pavarësisht nëse ajo është kuruar ose jo) janë më të rrezikuar për insult cerebral.⁴² Insulti cerebral dëmton trurin për shkak të bllokimit të qarkullimit të gjakut apo plasjes së një ene gjaku në tru. Sipas një studimi, moshë mesatare për insultin e parë cerebral ishte 41,8 vjeç për individët me sindromën Down dhe 57,1 vjeç për individët pa sindromën Down.⁴²

Megjithëse sëmundjet e lindura të zemrës janë më të zakonshme, disa faktorë të tjerë rrisin riskun për insultin cerebral janë më pak të zakonshëm, duke përfshirë hipertensionin (presioni i lartë i gjakut) dhe aterosklerozën.⁴⁷⁻⁴⁹ Duke qenë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme lidhur me riskun për insult cerebral për të rriturit me sindromën Down pa histori të sëmundjeve të lindura të zemrës, rekomandojmë depistim për riskun e insultit cerebral për ta njësoj si për individët pa sindromën Down. Megjithatë, duke qenë se individët me sindromën Down me sëmundje të lindura të zemrës kanë risk më të lartë, ne rekomandojmë depistim dhe kujdes shtesë nëpërmjet vlerësimit, monitorimit dhe trajtimit të duhur të faktorëve të riskut, edhe pse nuk ka ende kërkime të plota nëse një gjë e tillë do të reduktojë mundësinë për insult cerebral. Individët që u nënshtrohen vlerësimit dhe trajtimit për faktorë rrisni dhe insult cerebral janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Faktorët individualë të riskut duhet të diskutohen me të rriturit me sindromën Down, me familjet, ofruesit e përkujdesjes dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor të tyre.

5

OBEZITETI



★ **Deklarata e praktikës së mirë 3** Të gjithë të rriturit me sindromën Down duhet të konsumojnë një dietë të shëndetshme, të ushtrohen rregullisht dhe të kontrollojnë kaloritë, në kuadër të një qasjeje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e peshës, kontrollin e oreksit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Përgjithësisht, obezitet konsiderohet një indeks i masës trupore (BMI) i barabartë ose më i madh se 30. BMI është një masë e proporcioneve trupore bazuar në peshën dhe gjatësinë e një individi. Sigurisht, duke qenë se individët me sindromën Down janë zakonisht më të shkurtër dhe mund të shtojnë peshë më lehtë, ata mund të jenë më të prirur të kenë një BMI më të madhe se 30. Shumë të rritur me sindromën Down janë obezë, kështu që pasojat shëndetësore të obezitetit përbëjnë një shqetësim të zakonshëm për të rriturit me sindromën Down, familjet e tyre dhe ofruesit e përkujdesjes. Për një gjendje të mirë shëndetësore dhe një cilësi të mirë jete, është shumë e rëndësishme të konsumohet një dietë e shëndetshme, të kontrollohen racionet, të konsumohen vaktet në orare të njëjta çdo ditë dhe të kryhen rregullisht ushtrime. Ne rekomandojmë gjithashtu ushtrim të përditshëm që përfshin edhe socializimin me të tjerët. Të rriturit me sindromën Down, familjet e tyre, ofruesit e përkujdesjes dhe profesionistët mjekësorë duhet t'i marrin së bashku vendimet lidhur me planifikimin e zgjedhjeve të tyre për sa u përket ushqimit dhe ushtrimeve.

REKOMANDIMI 10

Monitorimi i ndryshimeve të peshës dhe obezitetit duhet të kryhet çdo vit duke përllogaritur indeksin e masës trupore (BMI) tek të rriturit me sindromën Down. Duhet të ndiqet "*Behavioral Weight Loss Interventions to Prevent Obesity-Related Morbidity and Mortality in Adults*" nga Task-Forca e Shërbimeve Parandaluese të SHBA-së (USPSTF).⁵⁰


